

NË EMËR TË POPULLIT

28. 04. 2017
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri dhe me sekretaren juridike Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 lidhur me par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP nr.1906-8/15 të datës 30.10.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik me dt.02.03.2017, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit shtetit Abdullah Abedini, përfaqësuesit të dëmtuarës [REDACTED] në Ferizaj, si dhe të pandehurit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] komuna Ferizaj, i lindur më [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED]; gjinisë [REDACTED], ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, punëtor fizik, i pa martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal [REDACTED]

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 06.10.2015, në orën 17.50 min, në pyllin shoqëror, në vendin e quajtur “Stanet e Gremes” në rajonin ekonomik pyjor “Neredime -Jezerc”, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasurorë për vete apo për personin tjetër, është takuar nga roja e pyllit duke transportuar me traktor të markës “ [REDACTED] ” drunjët të pa damkosur dhe pa dokumentacion përkatës dhe atë sasinë prej 12.81 metër kubë, të cilët paraprakisht me motor share i ishte prerë, me të cilin veprim e ka dëmtuar [REDACTED] në Ferizaj në vlerë prej 1,729.35€.

me këtë ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 lidhur me par 2 të KPRK-së,

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe neneve 4,7,17,23,41,42.43,51,52,dhe 73 të KPK-së dhe nen. 365 të KPPK-së të pandehurin Arijan Avdyli, e

GJYKON

Me të cilin e gjykon me dënim me gjobë në shumën prej 400 (katërqind) Euro të cilin dënim është i obliguar ta paguaj 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si dhe

Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj dhe në të njëjtën kohë urdhëron që dënimi i shqiptuar me burgim të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 1 /një/ viti pasi ky aktgjykim të merrë formën e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale.

Obligohet i pandehuri që në emër të kërkesës pasurore juridike të dëmtuarës [REDACTED] në Ferizaj ti paguaj shumën prej 1,729.35.€

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II nr.1906-8/15 të dt.30.10.2015 e ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] komuna Ferizaj për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga nenin 358 par.1 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 02.03.2017, ku në fillim të shqyrtimit gjyqësor prokurori i shtetit Avdullah Abednini e ka lexuar akuzën, ndërsa në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit Avdullah Abednini ka deklaruar se mbetem pranë aktit akuzues dhe kualifikimit juridik të veprës penale duke i propozuar gjykatës që të pandehurin të shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Të akuzuarit [REDAKTUAR] konform nenit 325 të KPPK-së në shqyrtimin gjyqësor i është dhënë mundësia për tu deklaruar lidhur me fajësinë, ku i njëjti ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale me të cilat ngarkohet, duke deklaruar në mbrojtjen e tij se nuk është e vërtetë se i njëjti ka qenë në mal për të prerë drunjë ashtu siç është shkruar në aktakuzë, duke shtuar se ka ndodhur ndonjëherë babai I tij të merr drunjë të thata për vete dhe për nevoja të shtëpisë, pasi që i njëjti qëndron në Stanet e Gremes me bagëti, mirëpo nuk është e vërtetë se të pandehurin e ka takuar roja e pyllit, por dëshmitari-roja e pyllit këtë e ka bërë për shkak të hakmarrjes dhe raporteve jot ë mira që ka me axhallarët e tij, duke shtuar se I njëjti posedon traktorin [REDAKTUAR] mirëpo asnjëherë nuk ka shkruar në mal për të prerë dru.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të këtij vlerësimi vërtetohet gjendjen e fakteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen faktike gjykata e vërtetoi nga dëshmia e dëshmitarit-[REDAKTUAR] i cili në dëshminë e tij në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se gjatë periudhës së vitit 2015, ka qenë i punësuar si roje pylli pranë Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj dhe se e ka mbuluar rajonin ekonomik pyjor Nerdime-Jezerc. Dëshmitari ka deklaruar se data e saktë nuk i kujtohet por në bazë raportit që ka përpiluar me shkrim pranë të cilit raport mbetet, me date 06.10.2015 dikua pas dite e ka takuar të pandehurin A [REDAKTUAR] në ngastrën 61 në vendin e quajtur Stanet e Gremes, ku i pandehuri me traktorin e tij [REDAKTUAR], kishte prerë katër cope lisa ahu me diameter 65, 67,59 dhe 60cm, të cilat lisa i kishte prerë me motor share dhe kishte qenë duke i bërë metra-copa me share. Dëshmitari tutje në dëshminë e tij ka deklaruar se fillimisht ka folur me të pandehurin, ka kërkuar identifikim, mirëpo i pandehuri nuk i është përgjigjur dhe për këtë dëshmitari ka deklaruar se nuk e ka zgjatur më shumë vetëm se e ka bërë matjen e drunjëve të prerë ku prezent ka qenë edhe i pandehuri dhe pas matjes së drunjëve dëshmitari ka deklaruar se është larguar nga aty.

Gjykata dëshminë e dëshmitarit [REDAKTUAR] roje e pyllit e ka vlerësuar si të besueshme pasi që e njëjta është objektive, reale dhe gjene mbështetje edhe në provat tjera materiale, siç është fletëparaqitja e rojës së pyllit, procesverbali i komisionit të ekspertëve të pylltarisë për vlerësimin e dëmit të shkaktuar nr.NP.41/2015 dhe raporti i rojës së pyllit i datës 06.10.2015, e gjithashtu dëshmitari në shqyrtimin gjyqësor e ka identifikuar të pandehurin, se i njëjti person është personi që e ka takuar duke prerë dru me date 06.10.2015 në vendin e quajtur Stanet e Gremes.

Gjykata gjithashtu vlerësoi edhe e mori në konsideratë edhe mbrojtjen e të akuzuarit, mirëpo gjykata një mbrojtjes së tillë nuk e vlerësoi si të besueshme, sepse mbrojtja e të pandehurit është kontradiktore, nuk është e mbështetur në prova dhe fakte, por më shumë është e orientuar nga fshehja e veprimeve inkriminuese me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale,

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit [REDAKTUAR] manifestohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja pylli nga neni 358 par.1 lidhur me par.2 të KPRK-së të kryer, vendin, kohën, në mënyrën dhe rrethanat e përshkuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ku i akuzuari në pyllin shoqëror, në vendin e quajtur "Stanet e Gremes" në rajonin ekonomik pyjor "Neredime -Jezerc", me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasurorë për vete apo për personin tjetër, është takuar nga roja e pyllit duke transportuar me traktor të markës [REDAKTUAR] drunjë të pa damkosur dhe pa dokumentacion përkatës dhe atë sasinë prej 12.81 metër kube, të cilët paraprakisht me motor share I ishte prerë, me të cilin veprim e ka dëmtuar [REDAKTUAR] në Ferizaj në vlerë prej 1,729.35€.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 të KPRK-së ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata të akuzuarit si rrethana lehtësuese i mori parasysh faktin se nuk ka të dhëna se i akuzuari më parë ka qenë i dënuar për ndonjë veprë penale, gjendjen e tij familjare dhe ekonomike, e në mungesë të rrethanave rënduese vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale duke i shqiptuar dënim si në dispozitiv të aktgjykimit me bindjen se një dënim i tillë është plotësisht i justifikueshëm dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale me bindje se me këtë lloj të dënimit, do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.


Konform nenit 463 par.2 të KPP-së i akuzuari është obliguar që të dëmtuarës [REDAKTUAR] në Ferizaj t'ia kompensoj dëmin në shumën prej 1,729.35€

Në bazë të nenit 450 të KPPK-së, gjykata të akuzuarin e ka obliguar që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej nga 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P. nr. 1359/15 dt. 02.03.2017

Sek.juridike
Drita Ejupi



Gjyqtari,
Mustaf Tahiri



KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

G. X. J.
2.3.17
